

Çfarë duhet të përmbajë ankesa?

- > të dhënat e plota të të interesuarit edhe firmën e tij
- > përshkrimin e shkurtër të problemit
- > kërkesën e të interesuarit
- > organin kundër të cilit drejtohet qytetari
- > veprimet që eventualisht kanë paraparirë dhe rezultatit e tyre
- > çdo të dhënë faktike apo informacion që mund të ndihmojë hetimin e çështjes

Qytetari informohet, nga menaxhuesi-ekspert i ankesës, për numrin e protokollit dhe stadin e ecurisë së çështjes së tij.

Me Avokatin e Popullit mund të komunikoni me mënyrat e mëposhtme:

Me telefon: **+30 213 130 66 00**
(E hënë – e premte 08.30-14.00,
të mërkurën 08.30-16.30)

Me fax: **+30 210 729 21 29, +30 213 130 68 00**

Me postë: Chalkondyli 17, K.P.10432, Athinë

Me e-mail për informacion të përgjithshëm:
press@synigoros.gr

Për depozitim anekse elektronike vetëm në linkun e mëposhtëm:
<http://www.synigoros.gr/e-complaint>

Në Internet www.synigoros.gr

Kush është dhe çfarë bën

AVOKATI I POPULLIT

 **THE GREEK OMBUDSMAN**
INDEPENDENT AUTHORITY

Botimi i fletëpalosjes u financua nga Hapësira Ekonomike Evropiane, Programi për Solidaritetin dhe Integrimin Social në Greqi (2009-2014)

 **eea grants**
 **norway grants**

 /Synigoros

 @Synigoros

Çfarë është Avokati i Popullit?

Avokati i Popullit është Autoritet i Pavarur i sanksionuar në Kushtetutë. Avokati i Popullit filloi të funksionojë më 1 tetor 1998 dhe u ofron shërbimet e tij **falas** gjithë qytetarëve.

Cili është misioni i tij?

Avokati i Popullit ndërmjetëson midis administratës publike dhe qytetarëve, me qëllim që të ndihmojë në ushtrimin efikas të të drejtave të tyre.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka, veçanërisht, si mision:

- mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijës
- avancimin e trajtimit të barabartë dhe luftimin e dallimeve në sektorin publik për arsye të preardhjes racore dhe etnike, bindjeve fetare ose bindjeve të tjera, invaliditetit, moshës apo orientimit seksual
- monitorimin dhe avancimin e zbatimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave:
 - > në çështje pune si në sektorin publik po kështu edhe në atë privat
 - > në aksesin e burrave dhe grave në të mirat materiale dhe shërbimet e sektorit publik

Avokati ndërmerr veprime të posaçme për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë.

Avokati i Popullit ndërmjetëson pasi qytetari i është drejtuar me shkrim organit me të cilin ka mosmarrëveshjen. Si ndërmjetës, formulon rekomandime dhe propozime ndaj administratës publike. Nuk vendos sanksione, as anulon aktet e paligjshme të administratës publike.

Kush mund t'i drejtohet Avokatit të Popullit?

Çdo qytetar grek ose i huaj që është rezident në Greqi ose jashtë saj dhe ka transaksione me shtetin grek. Shërbimet e Avokatit janë të disponueshme edhe për personat juridikë ose unionet e individëve.

Për ç'arsye?

Kur një veprim i paligjshëm ose mosveprimi i administratës publike ka shkelur të drejtën ose interesin e ligjshëm të qytetarit.

Cilat organe kontrollojnë Avokati i Popullit?

Avokati i Popullit ka në juridiksionin e tij kontrollin e shërbimeve **publike**, veçanërisht:

- ministritë (dikasteret qendrore dhe rajonale)
- qarqet, bashkitë
- arkat e sigurancionit social
- zyrat tatimore
- spitalet
- shkollat edhe universitetet
- zyrat urbanistike
- burgjet
- policinë
- Korporatën Publike të Energjisë (ΔΕΗ)
- Kompaninë e Ujësllësit dhe Kanalizimeve të Kryeqytetit (ΕΥΔΑΠ)
- Organizmin e Punësimit të Fuqisë Punëtore (ΟΑΕΔ) etj.

Si përjashtim, Avokati i Popullit mund të kontrollojë sjetlljen e individëve

- kur nëpërkëmbet e drejta e fëmijës ose
- ekziston trajtim i parabarabartë midis burrave dhe grave në çështje të punës

Në ç'raste NUK është kompetent Avokati i Popullit?

Avokati i Popullit nuk është kompetent:

- në rastet kur kanë kaluar 6 muaj që kur qytetari u informua për aktin e paligjshëm ose mosveprimin e administratës publike që ka lidhje me të
- të përfaqësuar qytetarët nëpër gjyqe
- të kontrollojë veprimet e individëve (por shih dy përjashtimet e sapopërmendura)
- për çështje që kanë të bëjnë me statusin e punonjësve të shërbimeve publike, përveç rasteve kur bëhet fjalë për diskriminim të palejueshëm në kurriz të nëpunësit për shkak të seksit, nacionalitetit, racës, moshës, invaliditetit e tj.
- për çështje që kanë lidhje me mbrojtjen kombëtare dhe sigurinë, politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit ose sigurinë shtetërore.
- për çështje pezull të gjykatave
- për akte të autoriteteve gjyqësore, të Këshillit Juridik të Shtetit, të autoriteteve të pavarura, të personave juridikë fetarë të së drejtës publike
- për akte ministrash dhe zëvendësministrash, në lidhje me menaxhimin e funksionit politik

Si paraqitet ankesa?

- **Personalisht** në zyrat e Avokatit të Popullit, në rrugën Chalkokondyli 17, K.P. 104 32 Athinë, në ditët dhe orët (E hënë – e premte 08.30-14.00, të mërkurën 08.30-16.30)
- Me dërgesë **postare** në adresën e mësipërme
- Me **fax**, tek numrat +30 210 729 21 29, +30 213 130 68 00
- Në mënyrë **elektronike** përmes linkut vijues, i cili jep mundësinë e monitorimit, në rrugë elektronike, të ecurisë së ankesës: www.synigoros.gr/e-anafora